



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, mori këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SHTATORES SË LEGJENDËS SË
FUTBOLLIT KOSOVAR FADIL VOKRRI

- I. **MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri.
- II. Lokacioni për vendosjen e shtatores së sportistit të njohur – futbollistit, Fadil Vokrri, shtrihet në pjesë të parcelave kadastrale nr. 6194-0, 6196-0 dhe 7726-0, ZK Prishtinë, në pronësi PSH - rrugë, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për vendosjen e shtatores së Fadil Vokrrit.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-239047/19, më 30.09.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën nr. 05-351/01-101192/19, dt. 07.05.2019, drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, e cila me Aktpërcjellës nr. 05-351/01-101192/19, dt. 14.05.2019, është përcjellë në kompetencë të Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës, ushtruar nga Federata e Futbollit e Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për caktimin e lokacionit për parkun “Fadil Vokrri”, si dhe vendosjen e shtatores së sportistit të njohur – futbollistit Fadil Vokrri, në këtë park.

Po ashtu, me shkresën nr. 3485/2019, dt. 15.08.2019, drejtuar Kryetarit të Komunës dhe kryesuesit të Kuvendit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka kërkuar të bëhet ndarja e një lokacioni të përshtatshëm afër stadiumit të Prishtinës “Fadil Vokrri”, për ta vendosur shtatoren e legjendës së futbollit kosovar, Fadil Vokrri.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga MKRS dhe Federata e Futbollit e Kosovës, në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, kanë identifikuar lokacionin për vendosjen e shtatores së futbollistit Fadil Vokrri, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë hapësirë me përmbajtje publike. Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelave kadastrale, nr. 6194-0, 6196-0, (sipas evidencave të pronësisë, e ndarë në 6 pjesë, por mungon pjesa grafike e ndarjeve) dhe nr. 7726-0, ZK Prishtinë, në pronësi PSH - rrugë, KK Prishtinë.

Lokacioni për vendosjen e shtatores në fjalë, është propozuar të jetë në afërsi të stadiumit “Fadil Vokrri”, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë caktimi i lokacionit sipas kërkesës së MKRS dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se kjo hapësirë e caktuar për vendosjen e shtatores, është sipërfaqe e gjelbëruar, e cila duhet të rregullohet dhe begatohet me lloje të ndryshme të gjelbërimit të ulët dhe të lartë, duke ruajtur gjelbërimin e lartë ekzistues në bazë të projektit ideor, i cili do të hartohet pas përcaktimit të lokacionit me këtë vendim.

Bashkëngjitur:


- Ortofoto e lokacionit,
- Shkresa nga MKRS,
- Lokacioni i propozuar për vendosjen e shtatores së Fadil Vokrrit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sport-Ministry of Culture, Youth and Sports



DATE/A:	15.08.2019
REFERENC-Ë:	MKRS
PËR/ZA/TO:	z. Shpend AHMETI, Kryetar i Komunës së Prishtinës, Kryesuesin e Asamblesë Komunale të Prishtinës, Shefat e grupeve të partive të përfaqësuara në Asamblenë Komunale.
NGA/OD/FROM:	z. Kujtim GASHI, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJEC	Kërkesë

I nderuar kryetar z. Ahmeti,
I nderuar kryesues i Asamblesë Komunale,
Të nderuar shefa të grupeve të partive të përfaqësuara në Asamblenë Komunale,

Fillimisht ju falenderoj për angazhimin dhe bashkëpunimin që keni treguar në vazhdimësi ndaj fushës së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

I nderuar kryetar, në shenjë falenderimi për kontributin e dhënë ndër vite në fushën e sportit, kemi vendosur që të ndërtojmë shtatoren për legjendën e futbollit kosovar, të ndjerin Fadil Vokrri.

Kërkojë nga ana juaj si kryetar i Komunës së Prishtinës, të bëhet ndarja e një lokacioni të përshtatshëm afër stadiumit të Prishtinës "Fadil Vokrri", për ta vendosur shtatoren e legjendës së Futbollit Kosovar Fadil Vokrri, gjithashtu kërkujmë të bëhet kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm që është në kompetencë të Komunës së Prishtinës.



Kujtim Gashi

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit